

**VENDIM**  
**Nr. 153, datë 13.6.2022**

**MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT  
QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “HEC-i KABASH  
POROCAN” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 5, nenit 7 dhe nenit 9, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 910/2 prot., datë 10.6.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë ‘HEC-i Kabash Porocan’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC-i Kabash Porocan” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.7.2015, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.7.2015.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 196/1 prot., datë 17.2.2022, shoqëria ka paraqitur kërkesën dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit për ndryshimin e ortakut kryesor të saj, nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave nga shoqëria “Erpa Invest” sh.p.k. tek shoqëria “Duferco Albania” sh.p.k., ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 196/2 prot., datë 4.3.2022, duke i evidentuar dokumentacionin e munguar. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 196/3 prot., datë 7.4.2022, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion, i cili rezultoi i paplotë përsëri. Duke marrë në konsideratë faktin që shoqëria nuk ishte plotësisht e qartë, në lidhje me dokumentacionin e këtij aplikimi, ERE i dërgoi shkresën vijuese nr. 196/5 prot., datë 18.5.2022. Shoqëria, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 196/6 prot., datë 23.5.2022 dhe nr. 196/9 prot., datë 10.6.2022, ka depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “HEC-i Kabash Porocan” sh.p.k. rezultoi se ajo ka plotësuar tërësisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit, që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit, që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021, si vijon:

- Paraqitja e kërkesës – neni 5, pika 2, 4 dhe 5.
- Përmbajtja e kërkesës dhe dokumentacioni i nevojshëm për dhënie e autorizimit nga ERE - neni 7, pika 1, germet “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, pika 2, germet “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e”, “f”.
- Dhënia e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut kryesor, nuk e çliron shoqërinë “HEC-i Kabash Porocan” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
- Shoqëria “HEC-i Kabash Porocan” sh.p.k. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa u përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut, që kontrollon interesat e shoqërisë “HEC-i Kabash Porocan” sh.p.k.

2. Ortaku i vetëm i shoqërisë “HEC-i Kabash Porocan” sh.p.k. bëhet shoqëria “Duferco Albania” sh.p.k.

3. Shoqëria “HEC-i Kabash Porocan” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për bërjen efektive të këtij transferimi, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi.

4. Dhënia e autorizimit nga ERE, për ndryshimin e ortakut kryesor, nuk e çliron shoqërinë “HEC-i Kabash Porocan” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera për këtë transferim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**